

VENDIM

Nr.373, date 14.7.2000

PER RIVENDOSJEN E SISTEMIT TE KUJDESTAREVE DHE TE ROJEVE, NE OBJEKTET MONUMENT KULTURE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te neneve 21 dhe 27, te ligjit nr .8279, date 29.7.1998, "Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit te shtetit te Republikes se Shqiperise", te nenit 7, te ligjit nr.8554, date 10.12.1999, "Per buxhetin e shtetit te vitit 2000" dhe te neneve 2 dhe 116, te ligjit nr.7867, date 12.10.1994, "Per mbrojtjen e pasurise kulturore te luajtshme dhe te paluajtshme", me propozimin e ministrit te Kultures, Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rivendosjen e sistemit te kujdestareve dhe te rojeve, ne objekt monument kulture.
2. Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sporteve, ne buxhetin e vitit 2000, t'i shtohet fondi prej 3 270 000 (tre milione e dyqindeshtatedhete mije) lekesh, ne zerin "shpenzime operative" .
3. Ky fond te perballohet nga fondi rezerve i Keshillit te Ministrave.
4. Ngarkohet Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve qe:
 - a) te hartoje listen e monumenteve te kultures, qe do te vendosen nen kujdestari, apo ne ruajtje;
 - b) te beje shperndarjen e fondit, te miratuar sipas listes se mesiperme;
 - c) te nxjerre aktet ne zbatim te ketij vendimi.
5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta